



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi

VENDIM

Nr. 168, Datë 19. 07.2018

MBI

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË PROPOZUARA NGA TAP AG NË
METODOLOGJINË E TARIFAVE TË TAP AG TË MIRATUAR ME VENDIMIN E
ERE-S NR.127 DATË 7/11/2013**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 38 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, paragrafit 4.2, pika 1 e Final Joint Opinion miratuar me Vendimin nr. 64, datë 13.06.2013 si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 19.07.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi miratimin e ndryshimeve të propozuara nga TAP AG në Kodin e Tarifave të TAP të miratuar me vendimin e ERE nr.127 datë 7/11/2013,

Konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, ERE rregullon çështjet që lidhen ndër të tjera me përjashtimin e aksesit të palëve të treta,
- Rregullimi i çështjeve që lidhen me përjashtimin e aksesit të palëve të treta, bazohet në përcaktimet e:

(1) Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në tekstin në vijim: Direktiva);

(2) Rregullores 713/2009/CE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në tekstin e mëtejshëm : Rregullorja ACER),

(3) Rregullores 715/2009/CE të Parlamentit European dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009,

(4) Rregullore se Parlamentit European dhe Komisionit, e dates 11 maj 2016, (Rregullore EU 2016/792),

- Vendimit Nr 27, datë 01.03.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE, “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP – AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) të Direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline”;
- Vendimit nr. 64, datë 13.06.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE “Për amendimin e Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE, nr. 27 datë 1.03.2013 “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP- AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të Direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline”, për marrjen në konsideratë të Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr 1/2013) dhe Vendimit të Komisionit European (C(2013)2949” nëpërmjet miratimit të dokumentit “Opinion i Përfundimtar i Përbashkët i Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP AG për Përjashtim. Autoriteti për Energjinë Elektrike dhe Gazin (Itali), Enti Rregullator i Energjisë (Shqipëri) dhe Autoriteti Rregullator i Greqisë (Greqi)”/ “Final Joint Opinion of the Energy Regulators on TAP AG's Exemption Application Autorita per l'Energia Elettrica e il Gas (Italy), Enti Rregullator i Energjisë (Albania) and Regulatory Authority of Greece (Greece)”;
- Sipas paragrafit 4.2, pika 1 e Final Joint Opinion, dhënia e përjashtimit nga tarifata e rregulluara për produktet forward-flow sanksionohet edhe me plotësimin e disa kushteve të tilla si :
 - a. Metodologjia e Tarifave që do të aplikohet nga TAP AG do jetë subjekt i aprovimit të përbashkët të Autoriteteve;
 - b. Tarifata duhet të jetë koherente me parimet e formuluar në Vendimin e Autoriteteve për Përjashtim (Final Joint Opinion), që përfshin ndërmjet të tjerave aplikimin e të njëjtës tarifë për të njëjtin produkt pavarësisht nëse ai është i ofruar prej kapacitetit të përjashtuar nga aksesimi i palëve të treta apo prej kapacitetit jo të përjashtuar;
 - c. Metodologjia e tarifave të përbëjë një strukturë tarifore të tipit hyrëse-dalëse/“entry – exit”. Ajo duhet të përmbajë mekanizmat e përcaktimit të

çmimeve për llojet e ndryshme të produkteve në drejtimin forward flow që kanë kohëzgjatje të ndryshme, janë të vazhdueshëm ose që mund të ndërpriten dhe në varësi të pikës së hyrjes (entry point) dhe të daljes (exit point).

d. Tarifa duhet të reflektojë kostot efikase, të jetë transparente dhe jo diskriminuese;

e. Tarifat duhet të jenë zbritëse në vijim të rritjes së kapaciteteve transportuese që do të përdoren;

f. Tarifa duhet të konsiderojë nivelin e ndryshëm të riskut të investimit fillestar dhe atë të zgjerimit të mëtejshëm kapacitetit..

- Paragrafi 4.2, pika 1 e Final Joint Opinion, i atribuon Autoriteteve edhe detyrën e monitorimit të vazhdueshëm në mënyrë që tarifa e aplikuar nga TAP AG të jetë në përputhje me metodologjinë e tarifave të miratuara. TAP AG duhet të bashkëpunojë me Autoritetet për këtë qëllim.
- Shoqëria TAP AG me letrën e datës 11 Tetor 2013, në kuptim të pikës 4.2, pika 1 të Final Joint Opinion, ka paraqitur pranë ERE një propozim të dokumentit të metodologjisë së tarifave, TAP Tariff Code. E njëjta kërkesë në të njëjtën kohë dhe e shoqëruar nga i njëjti dokument i është paraqitur për miratim edhe Autoriteteve Rregullatore të Italisë (AEEG) dhe Greqisë(RAE);
- Në këtë kuadër Enti Rregullator i Energjisë, miratoi Metodologjinë e Tarifave për Gazin me anë të Vendimit Nr. 127, datë 7.11.2013 , “Mbi miratimin e Metodologjisë së Tarifave (TAP Tariff Code), të propozuar nga TAP AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në “Opinionin e Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion”.
- Në fillim të muajit Nëntor 2013, Autoritetet miratuan, me vendime të veçanta, Kodin e Tarifave të TAP (TAP *Tariff Code*). (Vendimin e AEEG 495/2013/R/gas, datë 6/11/2013, vendimin e RAE 531/2013 datë 6/11/2013, Vendimin e ERE nr. 127 datë 7/11/2013). Kodi i miratuar i Tarifave të TAP përfshin pikën e mëposhtme: “Transportuesi duhet të marrë miratimin e rregullatorit para se të miratojë ndryshimet tek Kodi i Tarifave të TAP si kërkohet nga Neni 4.2.1 i Opinionit të Përbashkët.”

Në datë 22 Qershor 2018, TAP AG u dërgoi një letër Autoriteteve ku ju kërkonte disa ndryshime tek Kodi i Tarifave të TAP: Në datë 22 Qershor 2018, TAP AG u dërgoi një letër Autoriteteve ku ju kërkonte disa ndryshime tek Kodi i Tarifave të TAP:

- Tek formula që synon përshkallëzimin e të ardhurave (§2.1), indeksi MUICP (Indeksi i Bashkimit Monetar për Çmimet e Konsumatorëve) si përcaktohet në

Rregulloren e Këshillit (EC) Nr 2494/95 datë 23 Tetor 1995 është zëvendësuar me HICP (Indekset e Harmonizuara të Çmimeve të Konsumatorëve) si përcaktohen në Rregulloren (EU) 2016/792 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit datë 11 Maj 2016 mbi indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve dhe indeksin e çmimit të banesave, siç përcaktohet nga Eurostat.

- E njëjta formulë që synon përshkallëzimin e të Ardhurave të Pritshme (§2.1) duhet të përshtatet për vitet e brishta dhe në këtë mënyrë të Ardhurat e Pritshme qëndrojnë konstante midis viteve të brishta dhe viteve jo të brishta.
- Mekanizmi aktual i rishpërndarjes (si përmendet në paragrafin §5.1) parashikon rishpërndarjen e të ardhurave shtesë dy herë në vit. Ndryshimi parashikon shtrirjen e periudhës së rishpërndarjes me fundin e çdo viti për të mundësuar llogaritjen përfundimtare të të ardhurave shtesë krahasuar me të Ardhurat e Pritshme të vitit.

TAP AG u konsultua me transportuesit/tregtarët egjistues që kanë nënshkruar Gas Transportation Agreements, dhe paraqiti rezultatin e tyre pozitiv, të dokumentuar për Autoritetet nga TAP AG; (Lidhja/Ankesi C),

Duke konsideruar se:

- ndryshimet e propozuara janë në përputhje me parimet e përmendura tek Opinioni Përfundimtar i Përbashkët dhe veçanërisht të përmbledhura në pikat nga a tek f;
- në veçanti ato kanë për qëllim të përmirësojnë saktësinë dhe transparencën e metodologjisë së tarifave dhe nuk paraqesin pengesa të panevojshme për procesin e parashikuar të rezervimit afatshkurtër të kapacitetit;
- Aprovimi i këtyre ndryshimeve në Kodin e Tarifave është konsultuar me rregullatorët e Greqisë dhe Italisë, përaktësisht RAE dhe ARERA,
- Metodologjia e Tarifave e amenduar, do të propozohet nga TAP AG te përdoruesit e saj potencialë në momentin e ofertës së produkteve të kapaciteteve dhe për këtë arsye është e nevojshme të mbahen të rezervuara në Anekset B dhe C në këtë vendim.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë ndryshimet e propozuara nga TAP AG të Metodologjisë së Tarifave (Tap Tariff Code), të paraqitur nga shoqëria Tap AG me letërën e datës 22 qershor 2018, (Anekset B dhe C) të shprehur në vendimin e përbashkët me rregullatorët e Greqisë dhe Italisë, respektivisht RAE dhe ARERA (Anekset A);

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë TAP AG, Autoriteteve Rregullatore të Energjisë të Italisë (AEEG), Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe palët e interesuara, për marrjen e këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare me përjashtim të Aneksive B dhe C .

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi

Votimi i bordit të ERE për,

VENDIM

Nr. 168, Datë 19.07.2018

MBI

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TE PROPOZUARA NGA TAP AG NË
METODOLOGJINË E TARIFAVE TË TAP TË MIRATUAR ME VENDIMIN E
ERE-S NR.127 DATË 7/11/2013**

Antarët e bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Erjola Sadushi	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____

Autorità di regolazione per energia, reti e ambiente (ARERA, Italy)
Enti Rregullator i Energjise (ERE, Albania)
Ρυθμιστική Αρχή Ενέργειας (RAE, Greece)

Approval of Tap Tariff Code amendments

Proposed by TAP AG on the 22nd of June 2018

Whereas¹:

On August 29th 2011, TAP AG submitted to the Italian Ministry of Economic Development and on August 31st 2011 to the Regulatory Authority for Energy of Greece (RAE) an “Exemption Application for Trans Adriatic Pipeline”, as foreseen by Article 36 of the Gas Directive 2009/73/EC. On September 1st 2011 TAP AG submitted to the Energy Regulatory Entity (ERE) of Albania an “Exemption Application for Trans Adriatic Pipeline”, in accordance with Article 22 of the Gas Directive 2003/55/EC.

In June 2013 the Italian Ministry, RAE and ERE took the decision on the exemption, adopting the *Final Joint Opinion*, a document jointly written by AEEG, ERE and RAE (hereafter: “the Authorities”) and amended to comply with the Commission Decision [C(2013)2949 final] dated 16th of May 2013 and having taken note of the Opinion 1/2013 of the Energy Community Secretariat dated 14th of May 2013.

In the aforementioned document an exemption from the provisions of Article 41.6, 41.8, 41.10, among others, has been granted to TAP AG for a period of 25 years starting from the beginning of the Commercial Operation Date, under the following conditions:

1. TAP AG had to submit for the approval of the three Authorities the document containing the final methodology for the implementation of the TAP Tariff (hereafter: “*TAP Tariff Code*”).
2. The TAP Tariff had to reflect efficient costs, to be transparent and non-discriminatory and had to follow the principles described in the Exemption Application.
3. The methodology had to define the pricing mechanism for all forward capacity products offered by TAP, namely capacity products of different durations of firm and interruptible nature, for different entry and exit points.
4. The methodology defined is such that for any further capacity product offered additional to the initial forward capacity, the TAP Tariff is to be reduced.
5. The Authorities in deciding on the final tariff structure, when approving the *TAP Tariff Code* for the TAP pipeline, have to properly take into account and reflect in the accepted tariff, the relevant different risk levels attached to TAP’s investments in the Initial and Expansion Capacity.
6. The Authorities have to monitor regularly if the TAP Tariff complies with the approved methodology. TAP has to cooperate with the Authorities in performing this task.

Following the provision of the *Final Joint Opinion*, on the 14th October 2013 TAP AG submitted to the Authorities for approval the *TAP Tariff Code*.

At the beginning of November 2013, the Authorities approved, with separate but coordinated decisions, the *TAP Tariff Code* (AEEGSI Deliberation 495/2013/R/gas, dated 6/11/2013, RAE Decision 531/2013 dated 6/11/2013, ERE Decision n. 127 dated 7/11/2013). The approved TAP Tariff Code includes the following clause: “The

¹ Hereafter the definitions of the *Final Joint Opinion* apply.

Transporter must obtain regulatory approval before implementing any amendment of the TAP Tariff Code as required by Article 4.2.1 of the Joint Opinion.”.

On the 22nd of June 2018, TAP AG sent a letter to the Authorities, seeking for the following amendments of the TAP Tariff Code:

- a) In the Target Revenue escalation formula (§2.1), the index MUICP (“Monetary Union Index of Consumer Prices” as defined in the Council Regulation (EC) No 2494/95 of 23 October 1995) is replaced with HICP (“Harmonised Indices of Consumer Prices” as defined in the Regulation (EU) 2016/792 of the European Parliament and of the Council of 11 May 2016 on harmonised indices of consumer prices and the house price index), as provided by Eurostat.
- b) The same Target Revenue escalation formula (§2.1) is adjusted to properly account for leap years so that, else equal, the Target Revenue stays constant between leap years and non-leap years.
- c) The current redistribution mechanism (as stated in §5.1) foresees redistribution of additional revenues twice a year. The amendment foresees the alignment of the redistribution period with the end of each year in order to allow the final calculation of the extra-revenues compared with the Target Revenue of the year.

Whereas:

- as stated in the Final Joint Opinion and quoted at point 6 above, the Authorities have to monitor regularly if the TAP Tariff complies with the approved methodology;
- the proposed amendments are in line with the principles stated in the Final Joint Opinion and summarized in points 1 to 6 above; in particular, they are likely to improve the accuracy and the transparency of the tariff methodology and do not introduce undue barriers to the foreseen process of short-term booking of capacity;
- the proposed amendments affect the Gas Transportation Agreements that have been signed between TAP AG and each Shipper of the exempted capacity. Therefore, upon the Authorities’ request, TAP AG consulted these Shippers and presented to TAP AG their positive feedback, as documented to the Authorities by TAP AG;

the Authorities jointly

approve the amendments proposed by TAP AG and attached as ANNEX B. The amendments integrate the TAP Tariff Code as approved by respective decisions of ARERA, RAE and ERE (AEEGSI Deliberation 495/2013/R/gas, dated 6/11/2013, RAE’s decision is 531/2013 dated 6/11/2013, ERE Decision n. 127 dated 7/11/2013).